



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit
P-073

Prishtinë, më 24 tetor 2016, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C -301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 24TETOR 2016

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Sabri Hamiti dhe Fikrim Damka, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Zenun Pajaziti, Ismet Beqiri, Driton Çausi, Pal Lekaj, Haxhi Shala dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Avni Bytyçi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e Presidentit: Amir Haradinaj,

Nga Zyra e BE-së: Blerta Bejtullahu,

Nga OSBE-ja: Saniye Berisha dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme të Kryesisë së Kuvendit,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave dhe
4. Të ndryshme.

**** ***

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendit, të mbajtura më 3 dhe 10 tetor 2016

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 3 dhe 10 tetor 2016.

**** ***

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet për seancë plenare, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e Kuvendit të mbahet të enjten, më 27 tetor 2016, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*
3. *Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,*
4. *Propozim-deklarata e Kuvendit të Republikës së Kosovës adresuar Unionit Evropian për liberalizimin e vizave,*
5. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për procedurën përmbartimore,*
6. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-043 për faljen e borxheve publike,*
7. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-110 për kamatë-vonesat në transaksionet tregtare,*
8. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-024 për Shërbimin Mjekësor Emergjent,*
9. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-066 për profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës,*

10. Emërimi i anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave,
11. Zgjedhja e 1 (një) anëtari të Këshillit Prokurorial të Kosovës,
12. Zgjedhja e kryesuesit të Komisionit Shqyrtues në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit,
13. Zgjedhja e zëvendës drejtorit të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit,
14. Zgjedhja e 1 (një) anëtari të Bordit të Komisionit të Pavarur për Medie,
15. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e 1 (një) anëtari në Bordin e Ankesave të Komisionit të Pavarur për Medie,
16. Formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Shqipe Pantina, mbështetur edhe nga 8 (tetë) deputetë të tjerë nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” lidhur me Radiotelevizionin e Kosovës,
17. Debati parlamentar sipas kërkesës së deputetes Margarita Kadriu-Ukelli, mbështetur edhe nga 9 (nëntë) deputet tjerë nënshkrues lidhur me detyrimet e mundshme financiare të Kosovës për pretendimet e kompanive që kanë ushtruar padi në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit.

* * *

Kryesia, me propozim të nënkryetarit të Kuvendit, z. Fikrim Damka, pikën e rendit të ditës të propozuar për seancë plenare: Zgjedhja e 2 (dy) anëtarëve të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës, e hoqi nga rendi i ditës, si dhe nxori këtë:

Përfundim

Kërkohet nga Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës që ta shqyrtojë kërkesën e znj. Besa Bytyqi për mospërfshirjen e saj në rekomandimin e Komisionit ad hoc për zgjedhjen e 2 (dy) anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

* * *

Gjithashtu, Kryesia lidhur me pikën 15 të lartshënuar të rendit të ditës nxori këtë:

Përfundim

1. Grupet parlamentare të Kuvendit duhet që deri në seancën e radhës, më 27 tetor 2016, t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e 1 (një) anëtari në Bordin e Ankesave të Komisionit të Pavarur për Medie.
2. Përbërja e Komisionit ad hoc duhet të jetë, si në vijim: GP i PDK-së, 2 anëtarë; GP i LDK-së, 2 anëtarë; GP i LVV-së, 1 anëtar; GP i AAK-së, 1 anëtar; GP Lista serbe, 1 anëtar; GP “Nisma”, 1 anëtar dhe GP “6+”, 1 anëtar.

3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave

1. Propozimi për harmonizim e një draft-deklarate nga Komisioni për Punë të Jashtme për liberalizimin e vizave

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me çështjen e lartshënuar, Propozim-deklaratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës adresuar Unionit Evropian për liberalizimin e vizave e radhiti në rend të ditës për seancën plenare të radhës, që do të mbahet më 27 tetor 2016, në orën 10:00.

2. Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa për transferin e mjeteve buxhetore për Radiotelevizionin e Kosovës për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2016

Kryesia u njoftua me shkrim nga Komisioni për Buxhet dhe Financa lidhur me shqyrtimin e raportit të shpenzimeve për periudhën janar - shtator 2016 dhe Programin e shpenzimeve për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2016 të Radiotelevizionit të Kosovës, si dhe me rekomandimin e bërë Ministrisë së Financave, respektivisht drejtorit të përgjithshëm të Thesarit, për transferin e mjeteve buxhetore nga llogaria e Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës nga buxheti i Radiotelevizionit të Kosovës - kategoria ekonomike subvencione dhe transfere në llogarinë e RTK-së, nr. 1110101219060187, për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2016, në shumën prej 2 400 000 (dy milionë e katërqind mijë) euro.

3. Njoftimi i Komisionit për Integrime Evropiane lidhur me vizitat zyrtare të realizuar në Gjermani dhe në Belgjikë

Kryesia u njoftua me shkrim me raportin e Komisionit për Integrime Evropiane lidhur me vizitat zyrtare të realizuar në Gjermani, nga data 26 - 28 shtator 2016, dhe në Belgjikë, nga data 29 - 30 shtator 2016.

4. Të ndryshme:

1. Kërkesa e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor lidhur me pagat e anëtarëve të Bordit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, nxori, këtë:

Përfundim

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa që ta shqyrtojë kërkesën e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor lidhur me pagat e anëtarëve të Bordit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 11:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale